



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1019, datë 06.11.2009

Për
caktim numeracioni sipërmarrësit “Bitri” sh.p.k

Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në mbledhjen e datës 06.11.2009, sipas rendit të ditës dhe procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme në fuqi, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 452, datë 02.05.2008, e ndryshuar me Vendimin nr. 746, datë 17.07.2009, bazuar në ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 115 “Marrja e Vendimeve dhe Struktura e Këshillit Drejtues”, mori në shqyrtim:

- Propozimin e Drejtorisë së Liçensimit për miratimin e kërkesës së sipërmarrësit “Bitri” shpk për caktimin e 1000 numrave gjeografikë për përdorim në bashkinë Berat.

BAZA LIGJORE :

- Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 8 – pika j) dhe nenet 80 deri 90;
- “Rregullorja për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike dhe Planit kombëtar të numeracionit” miratuar me VKD Nr. 932, datë 11.08.2009.
- Rregullorja e brendshme e AKEP miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues Nr. 170 datë 24.04.2004, e ndryshuar - neni 21, pika 17.

Ne përfundim të interpretimit të bazës ligjore dhe kërkesës së sipërmarrësit të sipërcituar, Këshilli Drejtues

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e sipërmarrësi “Bitri” shpk për caktimin e numeracionit, si më poshtë:

Nr	Bashkia	NDC	Diapazoni i SN		Kapaciteti i alokuar i SN	Konfigurimi i NSN (NDC+SN)
			Fillim	Mbarim		
1.	Berat	32	600.000	600.999	1.000	XX YYYYYY

- a) Formati i Numrit Sinjifikativ Kombëtar (NSN) është me 8-shifra, dhe ka konfigurimin e treguar në kolonë, ku shenjat **X** tregojnë sasinë e shifrave që formojnë NDC (Kodin e Destinimit)

Kombëtar - *National Destination Code*) dhe shenjat **Y** tregojnë sasinë e shifrave që formojnë SN (Numrin e Pajtimtarit - *Subscriber Number*).

b) Formati i numrit për të realizuar thirrje :

- Kombëtare brenda Zonës së Numeracionit - vetëm SN
- Kombëtare jashtë Zonës së Numeracionit - **0 + NDC + SN [0 + NSN]**
- Ndërkombëtare: - **00 + CC + NSN**
[ku : CC-Kodi (Prefiksi) i Vëndit]

c) NUMERACIONI I SHKURTUAR

- 0** - Prefiksi për thirrjet kombetare (brenda vëndit por jashtë zones perkatese te numeracionit)
- 00** - Prefiksi për thirrjet nderkombetare.
- 112** - Numri i urgjences ¹.
- 118** - Rubrika e sherbimeve te Informacionit ².
- 120** - Prenotim i komunikimeve kombetare
- 1211** - Sinjalizim veshtiresish ne komunikimet kombetare.
- 1212** - Sinjalizim veshtiresish ne komunikimet nderkombetare
- 122** - Prenotim i komunikimeve nderkombetare.
- 123** - Njoftim per prishje linje, telefoni.
- 124** - Informacion per numeratorin.
- 126** - Policia Rrugore (*Sherbim Urgjence*) ³
- 127** - Urgjenca mjekesore (*Sherbim urgjence*) ⁴.
- 128** - Zjarrefiksati (*Sherbim urgjence*) ⁵.
- 129** - Policia e rendit (*Sherbim urgjence*) ⁶.
- 1891** - Hapja e kodit kombetar / nderkombetar nga terminale jo-multifrekuence.
- 1892** - Mbyllja e kodit kombetar / nderkombetar nga terminale jo-multifrekuence.

2. Ngarkohen Drejtoria e Liçensimit për njoftimin e këtij vendimi sipërmarrësit dhe Drejtoritë e tjera të AKEP për ndjekjen e efekteve që rrjedhin nga ky vendim.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES

Ilir SHEHU

Anëtarë të Këshillit Drejtues:

¹ . Thirrjet ne kete numer duhet te rrugesohen (direkt ose nepermjet bashkepunimet me sipërmarres te tjere te komunikimeve elektronike) ne poste sherbimi qe caktohen ne marreveshje me autoritetet shteterore kompetente te rrethit perkates.

² . Ne vartesi te sasise se sherbimeve te veçanta qe sipërmarresi kerkon te identifikojë brenda kesaj rubrike, kodi i shkurter "118" mund te konfigurohet edhe ne formen "118 X..". Ne kete rast nuk merret miratim ne AKEP, por vetem njoftohet.

³ . Thirrjet ne kete numer duhet te rrugesohen (direkt ose nepermjet bashkepunimet me sipërmarres te tjere te komunikimeve elektronike) ne poste sherbimi qe caktohen ne marreveshje me autoritetet shteterore kompetente te rrethit perkates.

⁴ . I njejte me shenimin nr.3.

⁵ . I njejte me shenimin nr.3.

⁶ . I njejte me shenimin nr.3.

1. Afrim TONUZI
2. Edlira KASAJ
3. Ilir ZELA
4. Jetmir KARINI